



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnih Posolova-Ministry of Internal Affairs.

Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit

2011-2014

Maj 2011

*Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar*¹

Shprehje e mirënjohjes (Ministri)

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 28, pika 3.

Lista e shkurtimeve

AMA	Agjencioni per Menaxhimin e Aseteve
BE	Bashkimi European
DKA	Drejtorite Komunale Arsimore
DMS	Departamenti i Mirëqënies Sociale
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DIPS	Departamenti –Instituti për Politikë Sociale
DMNV	Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
DHTQNJ	Drejtoria ei Hetimeve të Trafikimi me Qenie Njerëzore
ICITAP	US Embassy – International Criminal Investigative Training Assistance Program
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave Migruese
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
ILO	Organizata Ndërkombëtare për Punë
FMN	Fondi Monetar Nderkombetar
KE	Komisioni European
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KNK	Koordinatori Nacional Kunder Trafikimit
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MAP	Ministria e Administrates Publike

MD	Ministria e Drejtësisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizatata Jo Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkpunim Evropian
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
QJK	Qendra Juridike e Kosovës
QPS	Qendrat për Punë Sociale
RAE	Romë, Ashkali dhe Egjiptian
SA	Sekretariati Anti-Trafikim,
TQNj	Trafikimi me Qenie Njerzore
UNDP	United Nation Development Program
VT	Viktima e Trafikimit
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Përmbajtja

I. HYRJE.....10

I.1 NEVOJA PËR NJË STRATEGJI NACIONALE KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE 10

**I.2 PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET STRATEGJIA NACIONALE DHE PLANI I VEPRIMIT
KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE.....11**

PARIMI 1. PRONËSIA QEVERTARE E STRATEGJISË 12

PARIMI 2. PJESËMARRJA 13

PARIMI 3. QASJA E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT..... 15

PARIMI 4. QASJA NDËRDISIPLINORE DHE NDËRSEKTORIALE 16

PARIMI 5. QËNDRUESHMËRIA..... 16

I.3 FAKTORËT QË FAVORIZOJNË DHE ATO QË VËSHTIRESOJNË JETËSIMIN E STRATEGJISË 17

II. ANALIZA E SITUATËS DHE VLERËSIMI I MEKANIZMAVE EKZISTUES 18

II.1 SITUATA SOCIAL- EKONOMIKE E VENDIT18

II.2 GRUPET SOCIALE TË RREZIKUARA NDAJ TRAFIKIMIT.....19

II.3 MEKANIZMAT INSTITUCIONAL EKZISTUES20

II.4 MEKANIZMAT LIGJOR EKZISTUES	26
4.1 DOKUMENTET LIGJORE NDËRKOMBËTARE.....	26
4.2 DOKUMENTET LIGJORE QË RREGULLOJNË ASPEKTE TË NDRYSHME TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE	28
II.5 MEKANIZMAT OPERACIONAL EKZISTUES	30
5.1 PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PSV.....	30
5.2 STANDARTED MINIMALE TË KUJDESIT PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT	31

III. KUADRI STRATEGJIK-VIZIONI, MISIONI DHE SYNIMET STRATEGJIKE 32

1. VIZIONI	32
2. MISIONI.....	32
3. SYNIMET STRATEGJIKE	32
3.1 PARANDALIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERZORE.....	33
3.2 MBROJTJA DHE NDIHMA E VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE.....	34
3.3 HETIMI DHE NDESHKIMI I KRIMEVE TË TRAFIKIMIT	35
3.4 MBROJTJA E FEMJEVE.....	37
3.5 PARIMET E PËRGJITHSHME TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE MBI TE CILAT MBESHTETET KJO STRATEGJI.....	39

IV. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË 43

IV.1 ROLI I SISTEMIT TË MONITORIMIT	43
IV.2 KAPACITETET INSTITUCIONALE PËR MONITORIM DHE VLERËSIM	44
IV.3 TREGUESIT E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT	45
IV.4 INSTRUMENTET E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT	46
IV.5 SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT	46
IV.6 MODELI PËR MONITORIM.....	47
<u>V. PLANI I VEPRIMIT</u>	<u>49</u>
V. 1 PARANDALIMI.....	49
V.2 MBROJTJA	58
V.3 NDJEKJA DHE NDESHKIMI	66
V.4 MBROJTJA E FEMIJËVE	81

I. HYRJE

I.1 Nevoja për një strategji nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Qeniet Njerëzore, është një detyrim që rrjedh nga prioritetet që ka përcaktuar (apo Parashtruar) Republika e Kosovës, për të luftuar krimin e organizuar dhe të gjitha format e shfaqjes së tij. Megjithëse, pas vitit 1999, Kosova ka shënuar një progres të dukshëm në drejtim të forcimit të rendit, sigurisë dhe reformimit institucional, trafikimi me qeniet njerëzore ekziston si një nga format e veçanta të krimit të organizuar, me pasoja dhe rrezikshmëri të lartë për shoqërinë dhe shtetin e Republikës së Kosovës.

Adresimi dhe trajtimi i trafikimit me qenie njerëzore, për shkak të natyrës së sajë komplekse kërkonë një vëmendje dhe qasje të veçantë. Përmes kësaj Strategjie Nacionale dhe Planit të Veprimit janë paraqitur nga ashpërsia e fenomenit të trafikimit njerëzor që vendi ynë po përballet dhe, vëmendje të veçantë se Qeveria e Kosovës dhe të aktorëve të tjerë të përqëndrohet në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Strategjia është e bazuar në një konsensus të gjerë të të gjithë akterëve mbi synimet strategjike dhe masat e politikave prioritare që duhet të ndërmerren. Gjetjet e tyre u parapri nga një vlerësim të plotë të qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit 2008-2011.

Në këtë dokument, synimet strategjike dhe objektivat specifike, janë të përcaktuara qartë dhe janë mbështetur me masa publike dhe aktivitete, të argumentuara nga pikëpamja institucionale dhe financiare, si dhe të verifikuara nga një proces monitorues e vlerësues i përcaktuar në detaje².

Për më tepër Qeveria e Kosovës plotësisht është e përkushtuar në mbrojtjen e qytetareve të saj për kështu arsye reformat legjislative në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore janë në procesin e arritjes përfundimtare të miratimit,

Të gjitha këto iniciativa tregojnë se Qeveria e Republikës së Kosovës është dhe do të vazhdojë përpjekjet e saja në luftimin e trafikimit të Qenieve Njerëzore me kapacitete të plota institucionale.

Në mbështetje për hartimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit, kanë qenë përvojat dhe mësimet e nxjerra nga të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit 2008-2011. Nga analiza e bërë rezulton se, megjithë përparimet e bëra në hartimin e ligjeve për të parandaluar, dhe luftuar trafikimin me qenie njerëzore, Kosova duhet të vazhdojë me të gjitha kapacitetet institucionale luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Në këtë kuadër, Qeveria e Kosovës ka treguar që është e ngazhuar në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, këtë gjë e provon edhe renditja në Tier 2³.

I.2 Parimet mbi të cilat mbështetet strategjia nacionale dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore.

² Shiko kapitullin e IV të këtij dokumenti “Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë”.

³ <http://www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2010/142760.html>

Parimi 1. Pronësia qeveritare e strategjisë

- Strategjia si përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës

E hartuar për t'ju përgjigjur problemeve të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë, kjo strategji ka karakter vendor, ku përgjegjësinë në realizimin e synimeve strategjike, objektive dhe aktiviteteve e ka marrë Qeveria e Kosovës, nëpërmjet institucioneve të saj. Pronësia qeveritare e kësaj strategjie, është realizuar gjatë procesit të hartimit të saj. Strategjia dhe Planin Kombëtar i veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, është rezultat i bashkërendimit të përpjekjeve të qeverisë, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtar, zbatimi dhe monitorimi i së cilës do të kërkojnë të njëjtin bashkëpunim.

- Mbështetur në burimet e brendshme

Efekti financiar i strategjisë do të mbulohet kryesisht nga buxheti i Kosovës, i lidhur dhe i harmonizuar me Planin Buxhetor Afatmesëm , strategjitë sektoriale si ajo e arsimit, shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe punësimit.

- Strategjia si produkt i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar

Reformat dhe politikat e zhvillimit, ashtu sikurse përballimi i situatave të vështira politike që ka kaluar vendi, janë mbështetur gjerësisht nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Qeveria e Kosovës, është e ndërgjegjshme se zbatimi i strategjisë do të kërkojë para se gjithash mobilizimin e burimeve të brendshme njerëzore e materiale, por edhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, dhe institucioneve të specializuara ndërkombëtare. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës angazhohet për një përdorim efektiv të kësaj mbështetje.

Gjithashtu, mbështetja në institucionet e Kosovës dhe kapacitetet njerëzore të tyre për zbatimin e masave dhe aktivitetëve të parapara në PKV, ka siguruar “Pronësinë e Qeverisë së Kosovës” mbi strategjinë.

Parimi 2. Pjesëmarrja

Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore, nuk duhet parë dhe kuptuar si një përgjegjësi vetëm e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe strukturave të saj, për këtë arsye hartimi i Strategjisë, është realizuar përmes një sistemi të gjerë pjesëmarrjeje, që përfshinë institucionet qendrore, shoqërinë civile, organizatat jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, dhe partnerët ndërkombëtar. Pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesuara, përbën edhe një tipar dallues të kësaj strategjie. Ajo përbën një nga garancitë e suksesit të saj.

Struktura institucionale e hartimit të Strategjisë përbëhet nga; i) Koordinatori Nacional Kunder Trafikimit me qenie njerëzore, Sekretariati, grupet e punës (parandalimi, mbrojtja, hetimi dhe ndëshkim si dhe grupi fëmijët)

Koordinatori Nacional Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, koordinon dhe organizon punën për hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie⁴.

Sekretariati Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, ofron mbështetje për KNKT për koordinimin e të gjitha aktivitetëve kundër trafikimit, përfshirë dhe organizimin e punës për hartimin e PKV 2011-2014.

⁴ Ne baze të Vendimit të Qeverisë 029 date 10.04.2008

Grupet e punës⁵, janë përgjegjëse për elaborimin e problemeve sektoriale të strategjisë, dhe furnizimin me informacionin përkatës. Grupet e punës janë përzgjedhur në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë gjerësisht institucionet publike dhe shoqërinë civile.

Roli i partnerëve ndërkombëtar. Partnerët ndërkombëtarë kanë asistuar në mënyrë të vazhdueshme procesin e Vleresimit dhe analizës së PKV 2008-2011 si dhe atë të hartimit të strategjisë. Ata dhanë kontributin e tyre nëpërmjet inputeve të rëndësishme gjatë procesit të hartimit të strategjisë dhe punës me grupet tematike.

Në këtë dokument janë marrë parasysh rekomandimet e raportit të progresit për Kosovën nga KE për vitet 2009 dhe 2010.

Roli i partnerëve vendor dhe organizatave jo qeveritare konsiston jo vetëm në pjesmarrjen aktive gjatë procesit të hartimit të strategjisë por edhe në angazhimin e tyre si bartëse të veprimeve dhe partnere të organizatave shtetërore për hartimin e politikave, kryerjen e studimeve dhe kerkimeve në fushën e luftës kundër trafikimit me qenie njerzore si dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave.

ON-të dhe organizatat ndër-qeveritare aktive në vend mbështesin zhvillimin e strukturave koordinuese kombëtare duke ofruar aktorëve kryesor përvojë teknike, trajnime kur kërkohet, dhe përkrahje financiare për zbatimin e PKV,

- ON-të promovojnë qasjen e të drejtave të njeriut dhe ndihmojnë zbatimin e aktiviteteve kundër trafikimit, duke i lënë rolin udhëheqës aktorëve vendorë,

⁵ Krijuar me Vendim të Ministrit të Punëve të Brendëshme, datë 23.03.2011

- ON-të marrin pjesë në GPK si Kwshillues me qëllim që të këshillojnë KKKT dhe GPK sipas kërkesës,
- ON-të ofrojnë mbështetje për rrjetet e OJQ-ve dhe pjesëmarrje aktive në strukturën koordinuese, dhe
- ON-të ofrojnë përkrahje për strukturat qeveritare dhe partnerët social me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së iniciativave kundër trafikimit.

Parimi 3. Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut

Kjo strategji, ka një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, dhe është e lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e tyre, në veçanti në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit kur ato janë fëmijë dhe gra. Gjatë hartimit të këtij dokumenti, pjesëmarrësit kanë qenë të vetëdijesuar mbi të drejtat të cilat tentohen të shkelen gjatë trafikimit me qenie njerëzore, siç janë:

- E drejta për liri dhe sigurinë e personit,
- E drejta për të mos u mbajtur në skllavëri,
- E drejta për t'u trajtuar me humanizëm dhe respekt,
- E drejta e lëvizjes dhe liria për të zgjedhur vendbanimin,
- E drejta për gjykim të drejtë dhe mjete juridike efikase, lirimi nga praktikat e ngjashme me skllavërinë, ndalimi i punës së detyrueshme, liria e shprehjes dhe e drejta për qasje në informacion dhe mbrojtja e të dhënave personale.
- E drejta për të mos u torturuar dhe e drejta për të jetuar, e drejta në shëndet dhe e drejta në arsim⁶

⁶ Deklarata e OKB-se Per te drejtat e njeriut.

Për këtë arsye, qasja ndaj viktimave fokusohet në mbrojtjen e të drejtave, në aspektin e sigurimit të informacionit të nevojshëm, mbrojtjes fizike dhe ligjore, asistencës dhe kompensimit material për të mundësuar integrimin afatgjatë të tyre.

Një qasje e veçantë e këtij dokumenti, është dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Situata specifike e fëmijëve është marrë në konsideratë në të gjitha veprimet e parapara në Planin e Veprimit. Parandalimi i trafikimit të fëmijëve, dhe mbrojtja e veçantë e tyre nga viktimizimi, është konsideruar si një nga sfidat kryesore të kësaj strategjie.

Parimi 4. Qasja ndërdisiplinore dhe ndërsektoriale

Strategjia dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore, është një strategji sektoriale, dhe mbështetet në prioritetet e qeverisë për luftën kundër krimit të organizuar, dhe rritjen e nivelit të sigurisë në vend. Në të njëjtën kohë, ky dokument synon të koordinojë veprimet dhe aktivitetet me sektorë të tjerë të shërbimeve publike siç janë: arsimit, shëndetësia, shërbimet e punësimit, shërbimet sociale, shërbimet e inteligjencës, madje edhe me sektorë të tjerë të pavarur siç janë Policia, Prokuroria dhe Gjykatat. Ndërveprimi dhe bashkërendimi i veprimeve ndërmjet sektorëve, qëndron edhe në faktin se kjo strategji, synon në krijimin e një sistemi informacioni eficient, ku secili prej sektorëve do të pasurojë dhe do të ndihmojë, si në identifikimin e shkelësve të ligjit ashtu dhe në identifikimin dhe mbështetjen e viktimave.

Parimi 5. Qëndrueshmëria

Strategjia është konceptuar si një platformë synimesh dhe objektivash që nxit një pjesëmarrje aktive të grupeve të interesuara në zbatimin e saj. Qeveria si përgjegjëse kryesore, por edhe grupet e tjera, do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e strategjisë. Qeveria do të jetë e

vëmendshme për të përshtatur çdo vit, mbi bazën e rezultateve të monitorimit objektivat dhe aktivitetet me situatën reale të krijuar.

Qeveria gjatë hartimit të strategjise ka treguar kujdes që synimet dhe objektivat e vendosura të jenë të qarta, të përcaktuara mirë dhe të realizueshme, të mbështetura kryesisht në burimet materiale, financiare dhe njerëzore të cilat i ka Kosova sot.

I.3 Faktorët që favorizojnë dhe ato që vështiresojnë jetësimin e strategjisë

Disa nga faktorët që e favorizojnë jetësimin e strategjisë:

- Hapat pozitiv në reformat institucionale dhe stabilizimin e mjedisit politik,
- Pjesëmarrja e gjerë dhe e vazhdueshme e grupeve të interesuara në procesin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjisë,
- Mbështetja nga partnerët ndërkombëtar.

Disa nga faktorët që vështirësojnë dhe rrezikojnë jetësimin e strategjisë

- Rreziqet që lidhen me sigurinë rajonale.
- Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit jo adekuat të bartësve të kësaj strategjie.

II. ANALIZA E SITUATËS DHE VLERËSIMI I MEKANIZMAVE EKZISTUES

II.1 Situata social- ekonomike e vendit

Kosova, me një sipërfaqe prej 10.887 km² dhe popullsi rreth 2.4 milionë banorë⁷, ndodhet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik.

Ndryshimet e ndodhura në Rajonin e Ballkanit pas viteve 90-të, si pasojë e tensioneve dhe konflikteve të armatosura në ish Jugosllavi, kanë sjellë ndryshime të mëdha jo vetëm në hartën politike të rajonit, por edhe në situatën sociale ekonomike të vendeve. Kosova, me pozitën qendrore në Gadishullin Ballkanik, me burimet ekonomike e njerëzore, me lidhjet e shumta me vendet përreth, mundëson zhvillimin ekonomik e social duke ruajtur strukturën multietnike, dhe synon integrimin euroatlantik.

Kosova karakterizohet nga një popullsi e re në moshë, ku rreth 50 për qind është nën moshën 24 vjeç dhe vetëm 8 për qind e saj është mbi moshën 64 vjeç. Krahasuar me vendet e rajonit, Kosova ka shkallën më të lartë të papunësisë. Vlerësohet se në vitin 2008, 48 për qind e fuqisë punëtore ishte e papunë. Papunësia ka tendencë të jetë afatgjate, ku përafërsisht 82 për qind e të papunësuarve janë të papunë për më shumë se 12 muaj. Shkalla e papunësisë për të rinjtë është 73 për qind⁸. Po ashtu, kjo shkallë e papunësisë shënohet edhe me dallimet mes gjinisë. Shkalla e papunësisë për femrat është 55 për qind kurse për meshkujt është 39 për qind. Numri i nxënësve që detyrohen të largohen

⁷ Kjo shifer eshte mbeshtetur ne te dhena te peraferta, pasi qe nga viti 1981 nuk ka nje rregjistrim te popullsise se Kosoves.

⁸ ESK Anketa e Fuqise Punetore

nga shkolla vazhdon të jetë shqetësues, posaçërisht vajzat. Në periudhën 2005-2008, rritja e BPV u përshpejtua edhe njëherë me rritje mesatare vjetore prej mbi 4 për qind, dhe arriti në 5.4 për qind në vitin 2008⁹.

Indikatorët makroekonomik dhe tradicional shoqëror të Kosovës nuk janë inkurajues, me rritje të kufizuar të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) e cila nuk po ja del që të ulë shkallën e papunësisë prej 48 për qind dhe atë të varfërisë që vazhdon të mbetet në 45 për qind.

Këta tregues të ulët social ekonomik, ilustronë kontradiktat zhvillimore të vendit të cilat kanë gjeneruar jo vetëm probleme ekonomike dhe sociale por edhe probleme që lidhen me krimin e organizuar e veçanërisht me atë të trafikimit me qenie njerëzore. Aktualisht, Kosova konsiderohet si vend i origjinës, destinacionit dhe tranzitit të trafikimit të qenieve njerëzore¹⁰.

II.2 Grupet sociale të rrezikuara ndaj trafikimit

Trafikimi i qenieve njerëzore, është pjesë e krimit të organizuar. Ky krim përfshin individë të cilët luajnë rrole të ndryshme brenda territorit të një vendi ose vendeve të ndryshme. Viktimat e trafikimit, zakonisht lëvizin në mënyrë ilegale ndërmjet kufijve por mund të trafikohen edhe brenda vendit. Krimi i trafikimit ndahet në kategori në varësi të qëllimit të shfrytëzimit të viktimës. Nisur nga llojet e trafikimit konkludojmë se grupet sociale të rrezikuara ndaj trafikimit me qenie njerëzore janë femijet e të rriturit¹¹. Viktimat, femije e të rritur, detyrohen të migrojnë si rezultat i nivelit të lartë të varfërisë në vendet e origjinës, duke u joshur nga premtimet për një jetë më të mirë dhe

⁹ Te dhenat për treguesit janë marrë nga Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010, Tabela 2.2, faqe 38

¹⁰ Raporti i progresit KE Viti 2010

¹¹ Prezantimi i rangimit në radhe-ICITAP-US Embassy 13. Korrik 2008.

punë të ligjshme. Shumica e viktimave të identifikuarra së fundmi në Kosovë janë femra dhe vajza të mitura të trafikuar brenda vendit, dhe forma kryesore e shfrytëzimit mbetet ajo për qëllim të ofrimit të shërbimeve seksuale / detyrim në prostitucion¹².

II.3 Mekanizmat institucional ekzistues

Ekzistojnë disa institucione përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin të politikave shtetërore kundër trafikimit me qenie njerëzore.

Ministria e Punëve të Brendshme, e cila nëpërmjet Koordinatorit Nacional, Sekretariatit dhe Drejtorise për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ), punon në parandalimin e krimit dhe veprave të trafikimit, mbrojtjen dhe ndihmen e viktimave të trafikimit, ndjekjen, hetimin dhe arrestimin e kryerësve të krimit dhe prezantimin e fakteve dhe provave në prokurori.

Koordinatori Nacional Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, është një strukturë e re, e krijuar me vendim të Kryeministrit nr 029 datë 10.04.2008. Mandati i tij është të koordinojë, bashkërendojë, monitorojë dhe të raportojë mbi implementimin e politikave kundër trafikimit me qenie njerëzore, si dhe të kryesoje takimet me grupet punuese ndërministrare. Gjithashtu Koordinatori Nacional e kryen edhe detyrën e Raportuesit Nacional Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore.

Sekretariati, ofron mbështetje administrative dhe logjistike për punën e KNKT. Sekretariati punon si fuqi ngasëse për zbatimin e përgjigjes kombëtare kundër trafikimit. I udhëhequr nga KNKT, Sekretariati:

¹² Raporti i punës 6-mujore të SHTQNJ DKKO dhe regjioneve, për periudhën 6 mujore janar-qershor 2008.

Siguron ndërlidhjen e rregullt me anëtarët e GPK dhe me ata të GPT dhe komunikimin/këmbimin e rregullt të mendimeve në mesin e akterëve (p.sh. përmes buletinit dhe/ose webfaqe),

- Siguron shpërndarjen e të gjitha informatave përkatëse në nivel lokal dhe regional dhe brenda vendit,
- Udhëheqë me një bazë të të dhënave mbi projektet/kontaktet, si dhe një listë të OJQ-ve, që angazhohen rregullisht dhe është në dispozicion të akterëve,
- Mban kontakte të rregullta me donatorët në vend, dhe thërret takime të rregullta me të gjithë donatorët me qëllim që të koordinojë fondet dhe të shmangë dyfishimin e projekteve.
- Ben monitorimin e të gjitha aktiviteteve që zbatohen nga të gjithë akteret.
- Perpilon raport tre mujor të monitorimit të grupeve punuese anti-trafikim.

Grupi ndërministror, është një grup i përfaqësuesëve të institucioneve qendrore, mandati i të cilit është të koordinojë zbatimin e politikave, të monitorojë dhe raportoje çdo tre muaj mbi të arriturat në zyrën e Koordinatorit, përkatesisht të Sekretariatit antitrafikim. Në grupin punues ndërministror marrin pjesë nga dy anëtarë nga secila ministri dhe institucion përgjegjës, kurse OJQ-të vendore dhe partnerët ndërkombëtar përfaqësohen vetëm me një anëtar.

Keshilli Gjyqësor dhe Keshilli Prokurorial, janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të trafikantëve, ndëshkimin adekuat të tyre, për trajtimin jo diskriminues të viktimave të trafikimit para dhe gjatë gjykimit, për konfiskimin e pasurisë dhe asetëve të fituara me anë të veprës penale të trafikimit. Ato garantojnë zbatimin e ligjshmerisë për kompensimin e viktimave të trafikimit. Këto institucione janë përgjegjëse për të ofruar sigurinë para, gjatë dhe pas procedurave penale dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme dhe të mundshme me qëllim të mbrojtjes së viktimës nga

frikësimi, kërcënimet e ndëshkimet dhe ndëshkimet e të dyshuarit-(ve) ose të bashkëpunëtorëve të tyre, duke përfshirë edhe ndëshkimet nga personat në pozita të pushtetit. Nëse është e nevojshme, mbrojtja e ngjashme duhet të sigurohet për familjen ose miqtë e viktimës.

Ministria e Drejtësisë, e cila nëpërmjet Divizionit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (DMNV), ofron ndihmë juridike, mbrojtje dhe strehim për viktimat e trafikimit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila nëpërmjet strukturave të veta, që aktualisht janë Departamenti i Mirëqenies Sociale, Departamenti i Punës dhe Punësimit, Departamenti-Instituti për Politikë Sociale dhe Qendrat për Punë Sociale implementon politikat dhe i ofron shërbimet për mbrojtjen dhe ri-integrimin afatgjatë për viktimat e trafikimit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë e cila luan një rol tejet të rëndësishëm në fushën e parandalimit të trafikimit nëpërmjet edukimit, përmes të planprogrameve mësimore, qasjes ndërprogramore dhe aktiviteteve të ndryshme jashtëprogramore.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes Programit për Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore ofron trajnime dhe aktivitete vetëdijesuese për parandalimin e trafikimit për OJQ dhe grupet jo formale. Institucione të tjera qendrore si MAPL, MSH, MEF janë përfshirë me programe që adresojnë trafikimin me qenie njerëzore në mënyre direkte dhe indirekte.

Ministria e Shëndetësisë - luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e viktimave, përkatesisht në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit. Gjithashtu kjo ministri përmes trajnimeve dhe sesioneve informuese bën vetëdijësimin e personelit mjekësor në rastet e trajtimit të viktimave të trafikimit

Njësitë për të drejtat e njeriut, të cilat zbatojnë politikat e promovimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut në nivel qendror dhe lokal. Në kuadrin institucional, një rrol të rëndësishëm kundër trafikimit me qeniet njerëzore kanë luajtur institucionet ndërkombëtare partnere, dhe organizatat lokale joqeveritare.

**Struktura Organizative e Mekanizmit Koordinues, Monitorues dhe Implementues Kundër
Trafikimit me Qenie Njërzore në Kosovë**

Koordinatori Nacional

Sekretariati

Grupi Punues Ndërministror

Grup Këshillues:
OJQ-të vendore
Perfaqses të OJQ-të
ndërkombëtare

Ministria e Puneve të Brendshme
Policia e Kosovës
Keshilli Gjyqësor i Kosovës
Keshilli Prokurorial i Kosovës
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Niveli strategjik

Parandalimi:

ZKM- ABGj-
ZQM
Ministria e
Arsimit
Ministria e
Kulturës
Ministria
Pushtetit Lokal
MPB- Policia e
Kosoves
OJQ-të vendore
dhe
nderkombetare

Mbrojtja:

MPMS
Minsitria e
Shëndetësisë
MPB
Ministria e
Drejtësisë
MASHT
MAPL
MPB- Policia e
Kosoves
OJQ Vendore
Organizatat
nderkombetare

**Ndjekja dhe
ndeshkimi**

MPB – Policia e
Kosovës
KGJK
KPK

Të gjithë
vepruesit e
përfshirë në
zbatim

**Mbrojtja e
femijeve**

Të gjithë
vepruesit e
përfshirë në
zbatim

MPMS

MPB – Policia
e Kosovës

KGJK

KPK

II.4 Mekanizmat ligjor ekzistues

Sipas legjislacionit në fuqi¹³, trafikimi i personave përkufizohet si rekrutim, transferim, strehim ose pranim të personave, përmes kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, të abuzimit, të mashtrimit, të gënjimit, ose abuzimit të pushtetit, ose pozitës së vështirë, ose përbërjen apo pranimin e pagesave apo përfitimeve të tjera për të marrë pelqimin e personit që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim të shfrytëzimit. Baza ligjore e legjislacionit vendor, mbështetet në një sërë dokumentash dhe konventash ndërkombëtare.

4.1 Dokumentet ligjore ndërkombëtare

Një sërë dokumentesh dhe konventash ndërkombëtare¹⁴, përbëjnë bazën ligjore për hartimin e një legjislacioni adekuat kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

1. Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut- ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës
2. “Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Fundamentale dhe Protokollet e saj”
3. Korniza e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare.
4. Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor.
5. Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAE, 3.9.1981).
6. Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve, 2.9.1990.
7. Konventa e KE për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, 25.1.1996.

¹³ Kodi I perkohshem penal I Kosoves, neni 139

¹⁴ Janë marrë nga puna përgatitore e bërë mars 2008, mësimet e nxjerra nga Plani 2005-2007.

8. Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2005) dhe raporti i saj shpjegues
9. Protokollin opcional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, trafikimin, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve (2002)
10. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe politike dhe Protokollet e saj
11. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
12. Konventa kundër torturës dhe mizerive të tjera, trajtimit poshtërues apo jo human dhe keqtrajtimit¹⁵.
13. Protokollin i KB-së për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit me qenie njerëzore, Rezoluta e KB A/PEC/55/ 25 of 15.11.2000 (Protokollin i Palermos).
14. Konventa e KB-së kundër krimit të organizuar transnacional , Rezoluta e KB A/PEC/55 of 15.11.2000, efektive nga 29.9.2003.
15. Principet rekomanduese dhe direktivat mbi të drejtat e njeriut dhe trafikimi me qenie njerëzore, nga Komisionari i Lartë i KB-së për të drejtat e njeriut.
16. Konventa e ILO-së 182/2000 ndalimi dhe veprimi i menjëhershëm për eliminimin e formave të rënda të punës së fëmijëve.
- 17.
18. Konventa kundër rrembimit të fëmijëve 2004-29 koment dt 29,07 gr mbrojtja
19. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit, "Gruaja, Paqja dhe Siguria" .30 Tetor 2000.
20. Plani i veprimit të OSBE –së për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore PC.DEC/557.
21. Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e tyre 2010/0065 (COD), date 09/03/2011.

¹⁵ Konventat nderkombetare nuk jane ratifikuar specifikisht nga Kuvendi I Kosoves por hyjne ne fuqi ne baze te Kushtetutes se Republikes se Kosoves Neni 22 faqe 6

4.2 Dokumentet ligjore që rregullojnë aspekte të ndryshme të trafikimit me qenie njerëzore

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës 15 Qershor 2008.
2. Kodi Penal i Kosoves, 03/L-002, date 22/12/2008
3. Kodi i Procedures Penale 03/L-003, date 22/12/2008.
4. Ligji i Policise se Kosoves (rishqyrtim), 03/L-035, 04.06.2008
5. Ligji i punes No. 03/L-212 Date 02/11/2010
6. Ligji per Inspektoriatin e punes 03/L-017, 10.09.2008
7. Ligj per Inspektoriatin Sanitar te Kosoves, No.2003/22; date 06/11/2003
8. Ligji per Kodin doganor dhe akcizave te Kosoves 2008/03-L-109 date, 10/11/2008
9. Ligji per familjen 2004/32, date 20/01/2006
10. Ligji per administrimin e pasurise se sekuestruar ose te konfiskuar 03/L-141, 10/08/2009
11. Ligji per menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shteteror 2008/03-L065, date 21/05/2008
12. Ligji per mbrojtjen nga dhuna ne familje 2010/03-L-182, date 01/07/2010
13. Kodi i drejtesise per te mitur 2010/03-L193, date 08/07/2010
14. Ligj per sherbimet sociale dhe familjare (rishqyrtim) 02/L-17, date 01/05/2007
15. Ligji per barazi gjinore 2004/2, date 19/02/2004
16. Ligji per shendetsine 2004/4, date 19/02/2004
17. Ligji per parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik 2010/03-L-166, date 10/06/2010.
18. Ligji i Inspektoriatit policor te Kosoves (2008/03-L-036) , date 20/02/2008
19. Ligji per mbrojtjen e te dhenave personale 2010/03-L172, date 29/04/2010
20. Ligji per nderprerjen e shtatzanise 2008/03-L-110, date 06/11/2008

21. Ligj per dhenien e lejes se punes dhe punesimin e shtetasve te huaj ne Republiken e Kosoves, 2009/03-L-136, date 10/07/2009
22. Ligji per te huajt 2008/03-L-126, date 16/12/2008
23. Ligji per azil 2008/03-L-066, date 21/05/2008
24. Ligji kunder diskriminimit 2004/3, date 19/02/2004
25. Ligji per trashegimine 2004/26, date 28/07/2004
26. Ligj per perdorimin e substancave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursore, 02/L-128, 15.08.2008
27. Ligji per afesimin, riaftesimin profesional dhe punesimin e personave me aftesi te kufizuar, 2008/03-L-019, date 18/12/2008
28. Ligj per perkrahjen materiale familjeve te femijeve me aftesi te kufizuar te perhershme, 2008/03-L-022, date 16/05/2008
29. Ligj per fuqizimin dhe pjesmarje te rinise 2009/03-L-145, date 30/09/2009
30. Ligj “Per arsimin fillor dhe te mesem”
31. Ligji “Per pengimin e pastrimit te parave dhe veprave te ngjashme penale”,
32. Ligji “Per kujdesin shendetsor emergjent” Nr. 02/L-50, date 23/02 2006
33. Ligji per prishjen e rendit dhe qetesise publike 03/L-142, date 29/10/2009
34. Ligji per parandalimin dhe luftimin e semundjeve ngjitese 02/L-109, 15.10.2008

Kjo kornizë legjislative, mbetet e sfiduar nga zbatimi jo efikas i saj, pjesërisht për shkak të moskuptimit të ligjit nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe pjesërisht për shkak të mungesës së njohurive për dokumentet që mund të përdoren gjatë hetimit dhe ndeshkimit të këtyre shkeljeve. Vështirësitë konsistojnë në disa drejtime, së pari për të bërë dallime ndërmjet ligjit kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe ligjeve tjera, së dyti, në dhënien e dënimeve shkelësve të ligjit të cilat shpesh

janë minimale, dhe së treti në mungesën e legjislacionit dhe mekanizmave për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

II.5 Mekanizmat operacional ekzistues

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për viktimat e huaja dhe ato vendore dhe Standardet Minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit, janë aprovuar dhe zbatohen në koordinim të plotë nga të gjithë akterët që merren me identifikimin, mbrojtjen, dhe referimin e viktimave të trafikimit me qenie njerzore.

5.1 Procedurat Standarde të Veprimit PSV

Mbështetur në PSV, akterët e përfshirë në luftën kundër trafikimit me qenie njerzore kanë një marrëveshje sipas së cilës janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë përkatëse, për një koordinim dhe bashkëpunim sa më të mirë të veprimeve.

Me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar, është ngritur një sistem i mekanizmave kombëtare të referimit (MKR) për përmirësimin e mbrojtjes dhe sistemin referues për viktimat e trafikimit.

Duke ngritur MKR dhe MTR, nëpërmjet një kornize bashkëpunimi shtetet pjesëmarrëse përmbushin detyrimet e tyre për të mbrojtur dhe përkrahur të drejtat njerzore të viktimave të trafikimit në bashkërendim dhe partneritet strategjik me shoqërinë civile dhe akterë të tjerë që punojnë në këtë fushë¹⁶.

¹⁶ Manuali i ODIHR mbi udhëzuesit dhe parimet për të hartuar dhe vënë në jetë MKR mund të shërbejë si je burim i dobishëm këshillimi dhe informimi lidhur me rolin që kanë MKR në dhënien e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave. Në këtë aspekt ICMPD ka një kontribut të rëndësishëm në ndihmë të institucioneve të QK për të implementuar drejtë MKR dhe MTR

5.2 Standartet minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit

Standardet minimale për kujdesin e viktimave të trafikimit, janë një mekanizëm ndihmes në luftën ndaj dukurisë së trafikimit me qenie njerëzore. Dokumenti përcakton standardet minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit, që nga faza e identifikimit dhe bazohet në respektimin e parimeve themelore, si respektimi i të drejtave të njeriut, besueshmëria e krijuar në mes të viktimës dhe ofruesit të shërbimeve, respekti i plotë i vullnetit të viktimave të trafikimit nga ana e ofruesve të shërbimeve, mosdiskriminimi nga ofruesi i shërbimeve në baza gjinore, racore, fetare, të moshës, religjionit dhe gjendjes psikofizike.

III. KUADRI STRATEGJIK-VIZIONI, MISIONI DHE SYNIMET STRATEGJIKE

1. Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie, është “Koordinimi i luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore për të ndërtuar një shoqëri që jeton në paqe dhe e pa kërcënuar nga trafikimi dhe krimi i organizuar, duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e Kosovës, si një vend i qetë e me standarde të larta të sigurisë.

2. Misioni

Misioni i kësaj strategjie, është të përcaktojë prioritetet strategjike të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, të përcaktojë objektivat specifik të institucioneve që marrin detyrime në luftën kundër trafikimit, si dhe të harmonizojë veprimet ndërinstytucionale për arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu, misioni i kësaj strategjie është të sigurojë rritjen e cilësisë së shërbimeve, duke reduktuar dëmet e trafikimit ndaj shoqërisë si dhe të intensifikojë ndjekjen, persekutimin dhe dënimin e shkelësve të ligjit.

3. Synimet strategjike

Synimet strategjike janë formuluar për të dhënë një përgjigje adekuate ndaj çështjeve të trafikimit me qenie njerëzore, që duhen adresuar në të ardhmen, nëpërmjet metodave të reja ligjore e institucionale.

Strategjia trajton kater fusha kryesore:

1. Parandalimi i trafikimit
2. Mbrojtja dhe Ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve,
3. Hetimi, arrestimi dhe ndëshkimi i krimeve të trafikimit.
4. Mbrojtja e fëmijëve

3.1 Parandalimi i trafikimit të qenieve njerzore

Synim strategjik 1- Të ngrihet vetëdijesimi i publikut mbi çështjet e trafikimit me qenie njerzore

- **Objektivi specifik 1-** Të vetëdijesohen grupet e rrezikuara dhe ato të interesit (fëmijëve, të rinjve, gra, burra) për çështjet e trafikimit.
- **Objektiv specifik 2** – Të vetëdijësohet publiku i gjerë, lidhur me sanksionet ligjore për trafikimin me qenie njerzore.

Synim strategjik 2 –Te shtohet efikasiteti i parandalimit te trafikimit ne te gjitha nivelet e arsimit

- **Objektiv specifik 1-** Të plotësohen kurrikulat edukativo-arsimore me informacionet e duhura për parandalimin e trafikimit.
- **Objektiv specifik 2** – Të rritet përfshirja e grupeve të rrezikuara në arsimim joformal.
- **Objektiv specifik 3-** Të trajtohet me efikasitet problemi i braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Synim strategjik 3- Te ngriten kapacitetet e burimeve njerëzore në parandalim e trafikimit dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

- **Objektiv specifik 1-** Të zhvillohen dhe avancohen kapacitetet e institucioneve shtetërore në parandalimin e trafikimit.
- **Objektiv specifik 2** – Të ngriten kapacitetet e institucioneve arsimore në parandalim të trafikimit.
- **Objektiv specifik 3-** Të ngriten kapacitetet e OJQ-ve dhe grupeve joformale në parandalimin e trafikimit.
- **Objektiv specifik 4-** Të intensifikohet bashkëpunimi ndërinstytucional dhe me komunitetin në parandalimin e trafikimit

3.2 Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve

Synim strategjik 1- Te permiresohet identifikimi dhe referimi i viktimave te trafikimit me qenie njerëzore

- **Objektiv specifik 1-** Avancimi i procedurave ekzistuese të identifikimit dhe referimit për viktimat e trafikimit
- **Objektiv specifik 2** – Ngritja e kapaciteteve institucionale për identifikimin e viktimave të trafikimit

Synim strategjik 2 – Bashkerendimi & bashkeveprimi i suksesshem dhe cilesor i sherbimeve per viktimat e trafikimit

- **Objektiv specifik 1-** Avancimi i gjithëmbarëshëm i kornizës ligjore ekzistuese

- **Objektiv specifik 2** – Fuqizimi i mekanizmit referues, ngritja e kapaciteteve institucionale dhe ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme për viktimat e trafikimit
- **Objektiv specifik 3**- Sigurimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe afatgjate për viktimat e trafikimit

Synim strategjik 3- Reintegrimi i qendrueshem i viktimave te trafikimit

- **Objektiv specifik 1**- Avancimi i shërbimeve reinte-gruese afatgjate për viktimat e trafikimit
- **Objektiv specifik 2** – Bashkërendimi dhe bashkëveprimi i shërbimeve riatdhesuese për viktimat e huaja të trafikimit
- **Objektiv specifik 3** – Bashkërendimi dhe bashkëveprimi i shërbimeve për vendosje në vendet e treta për viktimat e trafikimit të përfshira në programin e dëshmitarit të mbrojtur

3.3 Hetimi dhe ndeshkimi i krimeve të trafikimit

Synim strategjik 1- Te avancohen teknikat e hetimit me qellimi te rritjes e efikasitetit kunder trafikimit te qenieve njerezore

- **Objektiv specifik 1**- Tëndryshohet dhe plotesohet korniza ligjore.
- **Objektiv specifik 2** – Ngritja e kapaciteteve institucionale (policisë, prokurorisë dhe gjykatave) në drejtim të përdorimit të teknikave të hetimit.
- **Objektiv specifik 3** – Kordinimi dhe bashkepunimi në mes te Policisë , Prokurorisë, Gjykatave, Doganave, Administrates Tatimore, dhe Inspektoriatet Perkatese.

Synim strategjik 2 – Te forcohet dhe Zhvillohet bashkepunimi me shetet tjera dhe organizatat nderkombetare per luftimin e trafikimit te qenieve njerezore

- **Objektiv specifik 1-** Bashkepunimi me Shtetet tjera dhe me organizatat Nderkombetare Interpol/Europol/Eurojust/Seci/Frontex per hetimet e perbashkta

Synim strategjik 3- Rritja e Efikasitetit dhe efektivitetit te Policise, Prokurorise dhe Gjykatave per hetimin dhe ndeshkimin e kryeresve te Trafikimit

- **Objektiv specifik 1-** Ngritja e kapaciteteve te policis Prokurorise dhe gjykatave
- **Objektiv specifik 2 –** Permiresimi i Politikave ndeshkimore per trafikantet dhe shkelesit e ligjit.

Synim strategjik 4- Konfiskimi i pasurise se fituar me trafikim dhe kompensim te viktimave

- **Objektiv specifik 1-** Arritja e Zbatimit te procedurave te konfiskimit te pasurise se trafikanteve.
- **Objektiv specifik 2-** Te zbatohen procedurat standarde per viktimat e trafikimit sipas ligjeve vendore dhe standarde nderkombetare .

Synim strategjik 5- Trajtimi adekuat dhe jo diskriminues ndaj viktimave

- **Objektiv specifik 1 –** Te zbatohen procedurat standarde per viktimat e trafikimit sipas ligjeve vendore dhe standarde nderkombetare

Synim strategjik 6- Te arrihet ngritje cilesore profesionale nepermjet trajnimeve

- **Objektiv specifik 1-** Trajnimi i Policise, Prokuroreve dhe Gjyqetarve

3.4 Mbrojtja e Femijeve

Për efekt të kësaj strategjie, do të përdorim disa terma, përkufizimet e të cilave janë si më poshtë:

Box 1.

"Fëmijë", do të thotë çdo person nën moshën 18 vjeç;

"Trafikimi i fëmijëve", do të thotë rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, strehimi, apo pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi brenda ose jashtë vendit.

"Shfrytëzimi i femijëve", Shfrytëzimi përfshin shfrytëzimin për qëllime prostitucioni ose ndonjë formë tjetër të shfrytëzimit seksual, shërbimet e detyruara të punës, kerkim lemoshe e detyruar, robëri, apo praktika të ngjashme të robërisë, skllavërisë, **shfrytëzimi për aktivitete kriminale**, heqjen e organeve, adoptimin e paligjshëm, martesën e hershme të detyruar dhe shfrytëzimin për punët e shtëpisë. Pëlqimi i fëmijës për qëllimet e shfrytëzimit është i parëndësishëm edhe nëse nuk janë përdorur asnjë nga masat në vijim: dhuna, detyrimi, rrëmbimi, mashtrimi, keqpërdorimi i pushtetit apo veprimet e kryera deri sa është në gjendje të dobësisë (cenueshmerise) apo nën kontrollin e personit

tjetër.

“Fëmijë viktimë e trafikimit”, është çdo viktimë nën moshën 18 vjeçare.

“Fëmije në rrezik”, janë fëmijët që janë të shfrytëzuar nga familja e tyre, (janë vëllezërit apo motrat e viktimave të trafikimit apo fëmijë të identifikuar përpara se të jenë të trafikuar).

“Fëmijë i pashoqëruar”, është çdo fëmije jashtë vendit pa prindërit e tij apo pa kujdestarin ligjor.

Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerezore 2011-2014 për Kapitullin e Fëmijëve bazohet në Instrumentat kryesorë ndërkombëtarë që lidhen me mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve viktimë të trafikimit¹⁷. Nga analiza e këtyre Konventave, standartet në fushën e mbrojtjes së fëmijëve viktimë të trafikut apo në rrezik trafikimi janë paraqitur në vijim. Ato pasohen nga parashikimet përkatëse të legjislacionit vendor.

¹⁷ Mekanizmat ndërkombëtarë që lidhen me mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve janë cituar në seksionin II.4 “Mekanizmat ligjorë ekzistues”

3.5 Parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare mbi te cilat mbeshtetet kjo strategji

Parimet që zbatohen gjatë gjithë fazave të përkujdesit dhe mbrojtjes së fëmijëve të trafikuar në vendin e origjinës, tranzitit ose destinacionit, ose në rast të trafikimit brenda vendit, sipas nenit 3 të Protokollit të Palermos janë¹⁸:

- **Respektimi i të drejtave të fëmijës:** Për të gjithë fëmijët, pra jo vetëm për fëmijët të cilët kanë shtetësinë e shtetit përkatës, por edhe fëmijët që kanë një shtetësi tjetër, apo fëmijët pa shtetësi, do të zbatohen dispozitat e KDF-së. Këto të drejta duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.
- **Interesi më i lartë i fëmijës:** Në të gjitha veprimet ndaj fëmijëve viktime, institucionet e përkujdesjes publike apo private, policia, gjykatat, autoritetet administrative, në vendimmarrjet e tyre, do të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.
- **Mosdiskriminimi:** Fëmijët viktime të trafikimit kanë të drejtën e mbrojtjes, qofshin ata jo shtetas, shtetas, me vendbanim në vendin ku ndodhen. Ata duhet të konsiderohen mbi të gjitha dhe para së gjithash fëmijë. Cdo fëmijë ka të drejtën e mbrojtjes pa diskriminim të çdo lloj forme për shkak të racës, seksit, gjuhës, besimit fetar, origjinës etnike ose sociale, ose çdo statusi tjetër, përfshi statusin e migrantit.
- **Respekti për pikëpamjet e fëmijës:** Një fëmijë viktimë, i cili është në gjendje të formojë pikëpamjet e tij ose saj ka të drejtë të shprehë lirisht këto pikëpamje në të gjitha çështjet që lidhen me të. Respekti për pikëpamjet e fëmijës do të garantohet gjatë procesit ligjor, mbrojtjes dhe përkujdesjes së ndërmjetme dhe identifikimit dhe zbatimit të një zgjidhje afatgjatë, veçanërisht në

¹⁸ Protokollit i Palermos, neni 3.

vendimet që lidhen me kthimin e mundshëm të fëmijës në familje, ose vendin e origjinës. Pikëpamjet e fëmijës do të kërkohen dhe do t'i jepet pesha e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë. Fëmijës duhet t'i jepet mundësia që të dëgjohet në të gjitha procedimet gjyqësore ose administrative që kanë lidhje me të, ose drejtpërdrejtë ose përmes një përfaqësuesi ligjor ose organi kompetent në përputhje me të drejtën e brendshme.

- **E drejta për informacion.** Fëmijët viktimë do të kenë akses në informacionin mbi situatën e tyre, si edhe për të drejtat, përfshi mekanizmat mbrojtës, shërbimet e tjera dhe procesin mbi bashkimin familjar ose riatdhesimin. Informacioni duhet të jepet në një gjuhë që fëmija është në gjendje ta kuptojë. Përkthyesit dhe psikologët duhet të sigurohen kurdoherë që një fëmijë pyetet ose intervistohet.

Parandalimi

Synimi strategjik 1 – Avancimi i sistemit të identifikimit dhe referimit të hershëm të fëmijëve në rrezik dhe viktimë të mundshme të trafikimit, si dhe ngritja e vetëdijësimit të shoqërisë për trafikimin e fëmijëve

- **Objektivi specifik 1** – Rishikimi dhe funksionalizimi i legjislacionit dhe politikave aktuale për identifikimin e fëmijëve viktimë të trafikimit
- **Objektiv specifik 2** – Avancimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse (qeveritare dhe jo-qeveritare) për identifikimin e hershëm të fëmijëve në rrezik trafikimi dhe viktimë të trafikimit
- **Objektiv specifik 3** - Fuqizimi dhe koordinimi midis institucioneve përgjegjëse (qeveritare dhe jo-qeveritare) në referimin e rasteve
- **Objektiv specifik 4** – Te ngritet vetëdijësimi i të gjitha kategorive shoqërore për rrezikun e trafikimit të fëmijëve.

Mbrojtja

Synimi Strategjik 2 – Avancimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në rrezik trafikimi dhe viktima të trafikimit në mënyrë të koordinuar ndërmjet institucioneve përgjegjëse duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve

- **Objektivi specifik 1** – Harmonizimi i kornizës ligjore vendore konform legjislacionit ndërkombëtar dhe adoptimi i politikave të reja ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në rrezik trafikimi dhe fëmijëve viktima të trafikimit
- **Objektiv specifik 2** – Avancimi dhe funksionalizimi i formave të mbrojtjes së fëmijëve në rrezik trafikimi dhe fëmijëve viktima të trafikimit me pjesëmarrjen e vetë fëmijut
- **Objektiv specifik 3** - Ngritja e koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse (qeveritare dhe jo-qeveritare) në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik trafikimi dhe fëmijëve viktima të trafikimit, me pjesëmarrjen e vetë fëmijës.
- **Objektivi specifik 4** – Funksionalizimi dhe avancimi i programeve afatgjate të ri-integrimit nga institucionet përgjegjëse për fëmijët në rrezik trafikimi dhe fëmijët viktima të trafikimit me pjesëmarrjen e vetë fëmijës
- **Objektiv specifik 5** – Avancimi i koordinimit të shërbimeve ri-atdhesuese për fëmijet viktimat të trafikimit

Ndjekja dhe Ndëshkimi

Synim strategjik 3– Të avancohen teknikat proaktive dhe reaktive të hetimit me qëllim rritjen e efikasitetit kundër trafikimit të fëmijëve në kuadër të krimit të organizuar

- **Objektiv specifik 1** – Përmiresimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe harmonizimi me direktivat e BE-së

- **Objektiv specifik 2** – Koordinimi i shërbimeve për vendosjen për vendet e treta, për fëmijet viktimë të trafikimit

Synimi Strategjik 4 - Rritja e efektivitetit të Policisë Prokurorisë dhe Gjykatave për hetimin dhe ndëshkimin e kryerësve të Trafikimit

- **Objektiv specifik 1** – Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të policisë, Prokurorisë dhe gjykatave, që merren me çështje të trafikimit me qenie njerzore

IV. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

IV.1 Roli i sistemit të monitorimit

